

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI PER KRIME TE RENDA-si gjykatë e shkallës së parë, me gjyqtarin Musa Konxheli kryetar i trupit gjykues dhe sekretaren juridike Lavdije Brahimi në lenden penale kundër të akuzuarit M.M. për shkak të veprës penale mbajtje në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.I.40/2016 të datës 28.04.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt. 27.06.2016 në prani të Prokurorit të shtetit Florije Salihu Shamolli, të akuzuarit M.M. dhe mbrojtësit të tij av. D.V. me dt. 27.06.2016 shpallë dhe publikisht komunikon këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari M.M. nga fsh. Komuna Shterrpcë data e lindjes..... në fsh.K. Shterrpcë, nga i ati B. e ëma M. e vajzërisë D., i martuar, serbë shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, pensionist invalidor, i gjendjes së dobët ekonomike.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datë 09.04.2016,rreth orës 07:30 në fsh. Komuna Shterrpcës, i pandehuri ka mbajtur në pronësi kontroll në mënyrë të paautorizuar në kundërshtim në shkeljen e ligjit të zbatueshem të armëve, gjatë një kontrolli-bastisje nga ana e policisë një vrime të hapur (bodrum) në qoshin e djathtë të dhomës të cilën vrimë e ka mbuluar me një kapak me dërrasa dhe përmbi kapak kishte vënë një shishe dhe kanta të ndryshme të plastikes ku në atë vrimë janë gjetur një pushkë automatike AK-47 me numër serik 370196 me mbishkrim 1987 M70 AB2 me një karikator dhe 30 copë fishek të kal.7.62 mm, tre karikator me nga 30 copë fishek të kal.7.62mm një karikator me nga 26 copë fishek të kal.7.62mm nëntë pako me nga 15 copë fishek të kalibrit 7.62mm, tetë copë fishek të kalibrit 7.62mm të shkapërderdhur pesë copë fishek të kal.7.62mm,manovrues,

nje fishek i kalibrit 5.6 mm, nje fishek i kalibrit te pa njohur, nje bombe dore e tipit M50 me nr. Serik 8511, dy karikator te armës automatike AK-47 te zbradura (pa fishek), nje thike e armës automatike AK-47, paisje per pastrimin e armës, dy qanta te vogla ushtarake dhe nje paisje e armës automatike AK-47 për vendosjen e tromblonit, ku gjithsej 306 fishek të cilët janë konfiskuar nga ana e policisë.

-me qka ka kryer veprën penale mbajtja ne pronësi, ne kontroll ,ose ne shfrytëzim te paautorizuar te armeve nga neni 374 paragrafi. 1 te KPRK-së.

Andaj gjykata ne baze te neneve 4, 7,17,41,46,73, e 374 parag 1 te KPRK-së, si dhe të nenit 365 te KPPK-së.

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumë **prej 450 (katërqind e pesëdhjet) euro** të cilin dënimin është i obliguar që ta paguaj ne afat prej 15 ditesh, pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

Ne rast se dënimi me gjobe nuk mund të ekzekutohet në format tjera të parapara me nenin 46 par 3 të KPRK-së, dënimi i caktuar me gjobe do ti shndërrohet ne dënim burgu, ashtu që për çdo 20 euro do ti llogaritet një dite burgu.

Në bazë të nenit 374 parag 3 te KPRK-se, konfiskohen në mënyrë të përhershme një pushkë automatike AK-47 me numër serik 370196 me mbishkrim 1987 M70 AB2 me një karikator dhe 30 copë fishek të kal.7.62 mm, tre karikator me nga 30 copë fishek të kal.7.62mm një karikator me nga 26 copë fishek të kal.7.62mm nëntë pako me nga 15 copë fishek të kalibrit 7.62mm, tetë copë fishek të kalibrit 7.62mm të shkapërderdhur pesë copë fishek të kal.7.62mm,manovrues, nje fishek i kalibrit 5.6 mm, nje fishek i kalibrit te pa njohur, nje bombe dore e tipit M50 me nr. Serik 8511, dy karikator te armës automatike AK-47 te zbradura (pa fishek), nje thike e armës automatike AK-47, paisje per pastrimin e armës, dy qanta te vogla ushtarake dhe nje paisje e armës automatike AK-47 për vendosjen e tromblonit, gjithsej 306 fishek.

Obligohet i akuzuari që kësaj Gjykate të paguaj paushallin gjyqësor në shume prej nga 30 (tridhjetë) euro, të gjitha këto ne afat prej 15 ditëve pasi qe aktgjykimi te merr formën e prerë.

Arsyetimi

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka ushtruar aktakuzën PP.I. 40/2016 të datës 28.04.2016 ndaj te akzuarit M.M. për shkak te veprës penale, mbajtja ne pronësi, ne kontroll, ne posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar nga neni 374 par. 1 te KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj qështje penale mbajti shqyrtimin fillestar me dt.27.06.2016 në të cilën, prokurori i Shtetit Florije Salihu Shamolli mbeti në tërësi pranë aktakuzës dhe cilsimit juridik të veprës penale duke shtuar se i pandehuri e ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare i cili pranim përputhet me të gjitha provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës dhe i propozon gjykatës që i pandehuri të shpallet fajtorë dhe ti shqiptohet dënim i paraparë me ligj.

I pandehuri, M.M. në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale, për të cilën e ngarkon aktakuza, gjithashtu i akuzuari shton se është penduar dhe i premtion gjykatës se ne te ardhmen nuk do te përsëris vepra penale te tilla ose te ngjashme, lut gjykatën qe ti shqiptoj një dënim sa më të butë.

Mbrojtësi i te pandehurit av. D.V. lidhur me pranimin e fajësi deklaroi: gjykatës i propozoj qe te mbrojturin tim ta dënoj me nje dënim sa mete bute dhe me rastin e caktimit te dënimi te ketë parasysh pranimin e fajësisë, premtimin se nuk do ta përsëris veprën penale, pendimin e sinqertë, pa dënueshme rinë tij e me rastin e caktimin e dënimit me gjobe kusht qe gjykata te ketë parasysh se ka te bej me personin i cili është pensionit invalidor te ardhurat e te cilit janë rreth 120 euro ne muaj nga te cilat mbahet, përpos tij është e sëmur edhe bashkëshortja e tij pra lus gjykatën ti ketë parasysh këto fakte kur te vendos mbi dënimin e tij.

Gjykata konstaton se janë plotësuar kriteret nga nen. 248 par.1 të KPPK-së nga se:

- i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë,

-pranimi i fajit është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pas konsultimeve me mbrojtësin e tij,

-i cili pranim mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit siç janë, vërtetimi për konfiskimin e armës të datës 09.04.2016 zingjiri i ruajtjes së armës i dt. 13.04.2016 si dhe foto dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësin e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, kryetari i trupit gjykues konform nenit 248 par. 4 të KPPK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit (*nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vleron se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mundë të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt. 19.03.2013*)

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit formësohen tiparet e veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të pa autorizuar të armeve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, meqë me datën kohën dhe vendin siqë është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi, i pandehuri ka poseduar pa autorizim armët pushkë automatike AK-47 me numër serik 370196 me mbishkrim 1987 M70 AB2 me një karikator dhe 30 copë fishek të kal.7.62 mm, tre karikator me nga 30 copë fishek të kal.7.62mm një karikator me nga 26 copë fishek të kal.7.62mm nëntë pako me nga 15 copë fishek të kalibrit 7.62mm, tetë copë fishek të kalibrit 7.62mm të shkapërderdhur pesë copë fishek të kal.7.62mm,manovrues, nje fishek i kalibrit 5.6 mm, nje fishek i kalibrit te pa njohur, nje bombe dore e tipit M50 me nr. Serik 8511, dy karikator te armës automatike AK-47 te zbrazura (pa fishek), nje thike e armës automatike AK-47, paisje per pastrimin e armës, dy qanta te vogla ushtarake dhe nje paisje e armës automatike AK-47 për vendosjen e tromblonit, gjithsej 306 fishek.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësin e dënimit në kuptim të nenit 73 të KPPK-

së, si rrethana **lehtësuese** mori se i pandehuri e ka pranuar fajësin për veprën e kryer penale, sjellja korrekte gjatë shqyrtimit, pendimin që ka treguar dhe zotimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra të tilla ose të ngjashme. Në mungesë të rrethanave veqanarisht rënduese gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe rrezikshmerinë konkrete të veprës penale. Mbi bazën e rrethanave të tilla i shqiptoi dënim me gjobë prej 450 (katërqind e pesëdhjet) euro të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pasi aktgjykimi të marrë formën e prerë, me bindjen se në rastin konkret edhe përmesë këtij dënimi do të arrihet qëllimi i dënimit me gjobë dhe qëllimi i përgjithëshëm i dënimeve, në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale duke konsideruar se një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

Konformë nen. 374 par .3 të KPRK-së, armët pushkë automatike AK-47 me numër serik 370196 me mbishkrim 1987 M70 AB2 me një karikator dhe 30 copë fishek të kal.7.62 mm, tre karikator me nga 30 copë fishek të kal.7.62mm një karikator me nga 26 copë fishek të kal.7.62mm nëntë pako me nga 15 copë fishek të kalibrit 7.62mm, tetë copë fishek të kalibrit 7.62mm të shkapërderdhur pesë copë fishek të kal.7.62mm, manovrues, një fishek i kalibrit 5.6 mm, një fishek i kalibrit të pa njohur, një bombe dore e tipit M50 me nr. Serik 8511, dy karikator të armës automatike AK-47 të zbrazura (pa fishek), një thike e armës automatike AK-47, pajisje për pastrimin e armës, dy çanta të vogla ushtarake dhe një pajisje e armës automatike AK-47 për vendosjen e tromblonit, gjithsej 306 fishek. Konfiskohen

Konformë nenit 450 par.2 nënpar 2.6 të KPPK-së obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 (tridhjetë) euro, e cila është caktuar duke pasur parasysh gjendjen ekonomike të pandehurit dhe komplikushmerinë e kësaj çështje penale.

Nga arsyet e sipërcekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI PËR KRIME TË
RËNDA**

PKR.82/16 i dt.27.06.2016

Sek.juridike

Lavdiqe Brahimi

Kryetari i trupit gjykues

Musa Konxheli

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, për mes kësaj Gjykate.